REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr 314 Prot Maliq më 15.01.2025

Projekt-Vendim - Nr. 11

Për

"Miratimin e Deklaratës të Misionit dhe Vizionit të Bashkisë Maliq për periudhën 2025-2029"

Në mbështetje të Ligjit nr .139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , Ligjit nr .9936,datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë " i propozoj Keshillit Bashkiak :

1. Të miratojë Deklaratën e Misionit dhe Vizionit të Bashkisë Maliq për periudhën 2025-2029 sipas materialit bashkëngjitur.
2. Kjo deklaratë është përditësuar pasi mbaroi afati i deklaratës ekzistuese për periudhën 2020-2024,propozojmë për miratim deklaratën dhe vizionin e Bashkisë Maliq për periudhën 2025-2029.
3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe Strukturat e tjera sipas funksioneve dhe fushave që mbulojnë ;
4. Ky vendi hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6, të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore " , i ndryshuar.

Konceptoi : J. Xhialli - Sekretrar i Përgjithshëm

KRYETARI I BASHKISË
Gëziza Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

DEKLARATA E MISIONIT DHE VIZIONIT TË BASHKISË MALIQ
2025-2029

Kjo deklaratë bazohet në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe shërben si dukument bazë në punën e organit të vetëqeverisjes vendore për 4-vitet e ardhshme.

Deklarata prezanton në mënyrë të përmbledhur, një përqasje ndaj decentralizimit dhe forcimit të qeverisjes vendore duke patur në themel qytetarin dhe shërbimet ndaj tij bazuar në akte ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Bashkia Maliq e krijuar sipas ligjit 115/2014 "Për ndarjen administrative territoriale të njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë ka një territor prej **697.8 km²** dhe e përbërë nga :

1. Njësia Administrative Maliq me qytetin Maliq dhe 6 fshatra;
2. Njësia Administrative Libonik me 13 fshatra ;
3. Njësia Administrative Pojan me 12 fshatra ;
4. Njësia Administrative Vreshtas me 4 fshatra ;
5. Njësia Administrative Pirg me 11 fshatra ;
6. Njësia Administrative Gorë me 18 fshatra ;
7. Njësia Administrative Moglicë me 17 fshatra :

Popullsia e Bashkisë Maliq sipas regjistrit të Gjendjes Civile **61.713 banorë**

Misioni dhe Vizioni i vetëqeverisjes vendore është mjaft i gjerë dhe synon të sigurojë një qeverisje sa më të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

a. Njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
b. Respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve;
c. Shërbime dhe lehtësi publike në dobi të komunitetit;
d. Ushtrim me efektivitet i funksioneve, kompetencave dhe detyrave nga organi i vetëqeverisjes vendore;
e. Nxitjen e pjesëmarrjes së komunitetit në qeverisjen vendore;
f. Realizimin e shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj apo akte nën ligjore;
g. Transparenca e çdo aktiviteti publik të Bashkisë Maliq.

Objektivat dhe programi strategjik i Bashkisë Maliq përfshin:

1. Zhvillimi gjithpërfshirës i sektorit të bujqësisë:
   - Mbështetja e prodhimit dhe produkteve vendase
   - Promovim i agropërpunimit
   - Përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse
   - Zhvillimi i agroturizmit
2. Përmirësimi i klimës së biznesit
   - Rritje e nivelit të produktivitetit
   - Përmirësimi i teknologjisë bujqësore dhe inovacionit
   - Partneritet rajonal e më gjerë
3. Zhvillimi i qendrueshëm i zonave të urbanizuara
   - Zbatimi i Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar në shërbim të komunitetit dhe biznesit

- Përmirësim i infrastrukturës
- Krijimi i hapësirave publike kreative e me standarte

4. Sigurimi i kohezionit social
   - Infrastrukturë arsimore, shëndetësore e shërbim parësor cilësor në të gjitha njësitë administrative
   - Arsimim dhe trajnim i fuqisë punëtore nëpërmjet qendrave të formimit profesional
   - Rritje të punësimit nëpërmjet politikave pro biznesit
5. Mbrojtja dhe promovimi i burimeve natyrore dhe kulturore
   - Menaxhim i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave
   - Promovim i vlerave turistike mjedisore
   - Krijimi i aktiviteteve shoqërore dhe kulturore
   - Promovim i trashëgimisë kulturore

Funksionet e Qeverisjes Vendore

- Funksionet e veta
- Funksionet e përbashkëta
- Funksionet e deleguara

Ligji 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" përcakton shumë saktë çdo funksion të bashkisë ku bazë janë qytetarët dhe shërbimi ndaj tyre.

Bashkia Maliq mban përgjegjësi të plotë për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe kapitalit financiar në dispozicion, brenda kuadrit ligjor të përcaktuar në vazhdimësi.

Në këtë kuadër evidentimi, vlerësimi dhë vënia në funksion e të gjitha aseteve është detyrë prioritare e organit të vetëqeverisjes.

Sigurimi i burimeve të mjaftueshme financiare është kusht dhe sfidë për realizimin e misionit të Bashkisë Maliq në vazhdimësi.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli janë një sistem politikash, proçedurash, veprimtarish nëpërmjet të cilave synohen të arrihen objektivat afat mesëm e afat gjatë, duke mundësuar dhe influencuar në ofrimin e sa më shumë shërbimeve publike.

Objektivat për katër vitet në vazhdim do të arrihen nëpërmjet :

a. Veprimtarive efektive, të efektshme dhe me ekonomi;
b. Ndjekjen në vazhdimësi të legjislacionit dhe akteve të brendshme të institucionit
c. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
d. Mbrojtjes se informacionit dhe aktiveve;

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi do jenë në vëmendje të punës sonë me qëllim rritjen e performancës së institucionit . Edhe plani i veprimit dhe zbatimit të strategjisë , përfshirë këtu edhe përcaktimin e përgjegjësive për çdo punonjës apo strukturë do jenë në vëmendjen tonë të vazhdueshme.

Për të realizuar misionin Bashkia Maliq do të vazhdojë të ndërmarrë disa hapa:

- Të rrisë efikasitetin në tërësinë e Drejtorive, Sektorëve apo Njësive Administrative;
- Dhënie përparësi ushtrimit të kompetencave të cilat kanë lidhje drejtpërsëdrejti me qytetarin;
- Forcimin e financave vendore dhe përdorimin me efikasitet të tyre;
- Planifikimi i shpenzimeve me efikasitet, duke siguruar transparencë dhe bashkërendim të objektivave strategjikë, me qëllim nxitjen e mëtejshme të zhvillimit ekonomik të njësisë së pushtetit lokal në të gjitha fushat;
- Do synohet mbajtja e ritmit të punës edhe për vitet në vazhdim me një zhvillim social ekonomik të harmonizuar në të gjithë territorin duke ulur pabarazinë në zhvillim midis njësive;
- Rritja e transparencës dhe pjesëmarrja sa më e gjerë e komunitetit, biznesit dhe shoqërisë civile në vendimmarrjet publike;
- Monitorimi i performancës së punonjësve të administratës si mekanizëm për të garantuar llogaridhënien dhe efikasitetin e shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Aktivizimin qytetar, nëpërmjet fuqizimit të strukturave komunitare (kryetarë dhe kryesi të fshatrave) :
- Përfshirjen e të rinjve dhe qeverive të nxënësve në vendimmarrjet publike por jo vetëm si pjesë e aktivizimit qytetar;
- Mbajtja në nivele të larta e përfaqësimit të grave dhe vajzave në strukturat qeverisëse, ekzekutive dhe administrative;
- Konsolidimi i administratës publike si një administratë e çburrokratizuar, e paanshme politikisht, profesioniste dhe transparente, e gatshme për t'ju përgjigjur ritmeve të kohës, pritshmërive të komunitetit, sfidave të bashkimit europian, thithjes së fondeve, duke respektuar standartet bazë të funksionimit të pushtetit lokal;
- Përmirësimi i marrëdhënieve ndërinstitucionale midis qeverisë qëndrore dhe asaj vendore, si një prioritet tjetër i rëndësishëm ndërinstitucional;
- Forcimi i bashkëpunimit institucional me shoqërinë civile apo donatorë të ndryshëm;
- Në kuadër të bashkëpunimit rajonal do synojmë të kontribuojnë maksimalisht në të gjitha fushat e programet ndërkufitare e rajonale;
- Garantimin e një qeverisje të hapur, transparente, me përfshirje të qytetarëve dhë komuniteteve si dhe llogaridhënie bazuar në sisteme të besueshme të performancës;
- Konsolidimi i infrastrukturës njerëzore dhe dokumentare si bazë e qëndrueshmërisë së institucionit;
- Rritjen e besueshmërisë së komunitetit ndaj administratës , duke i shërbyer me etikë, profesionalizëm dhe transparencë;
- Regjistrimin e plotë të aseteve të bashkisë në dobi të komunitetit, biznesit apo edhe aktorëve të tjerë , me qëllim rritjen e të ardhurave për pushtetin lokal dhe punësimit në territor;

<u>Për të realizuar misionin e vet bashkia me ligj kryen disa funksione:</u>

1. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike;
2. Funksione në fushën e shërbimeve sociale;
3. Funksione në fushën e kulturës,sportit dhe shërbimeve argëtuese;
4. Funksione në fushën e mbrojtjes së mjedisit;
5. Funksione në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike,natyrës dhe biodiversitetit;
6. Funksione në fushën e zhvillimit ekonomik vendor;
7. Funksione në fushën e sigurisë publike;

8. Funksione dhe kompetenca të deleguara

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve pubike do të synojmë:

a. Përmirësimin e mëtejshëm të furnizimit me ujë të pijshëm të banorëve në zonën e Njësisë Administrative Pirg;
b. Përfundimin e kanalizimit të ujërave të përdorura në të gjithë zonën urbane të bashkisë;
c. Përmirësim të mëtejshëm të sistemit rrugor në të gjithë bashkinë;
d. Përmirësim i shërbimit të pastrimit në vazhdimësi për të gjithë territorin;
e. Rritja e parqeve dhe lulishteve
f. Rritja e mëtejshme e ndriçimit publik në çdo fshat, rrugicë;
g. Mirëmbajtje e varrezave publike;
h. Rehabilitim i vazhdueshëm i godinave të arsimit dhe shëndetësisë;
i. Ngritje palestra sportive për shkollat e arsimit të mesëm e 9- vjeçar ;
j. Planifikim, administrim dhe kontroll sa më të mirë të territorit;

Në fushën e shërbimeve sociale:

a. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në nivel bashkie sipas përcaktimeve ligjore për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë , gratë e dhunuara, viktimat e trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj;
b. Ndërtimin dhe administrimin e banesave të shërbimit social dhe shërbimeve të tjera që kanë të bëjnë me strehimin
c. Ndërtimin dhe administrimin e qëndrave për ofrimin e shërbimeve sociale-vendore;
d. Bashkëpunimin me institucione qëndrore dhe donator për projekte që kanë të bëjnë me mirëqënien sociale, fondin social, financimin e shërbimeve sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

Në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese

a. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor;
   Prioritet kemi :
   -Ngritjen e Muzeut Arkelogjik Maliq.
   -Ngritjen e fshatit palafitik.
b. Përmirësim i nivelit artistik të aktiviteteve kulturore, promovimin e vlerave të zonës, promovim i vlerave turistike të zonës;
c. Organizim i vazhdueshëm i aktiviteteve sportive , çlodhëse, e argëtuese;
d. Kthimi në Kategorinë e I-rë të Klubit të Futbollit Maliq;

Në fushën e mjedisit

a. Mbrojtje të mjedisit, tokës dhe ujit nga ndotja;
b. Mbrojtje akustike të territorit;
c. Zhvillim aktivitete edukuese dhe promovuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit

Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pyjet- Kullotat, Biodiversiteti

a. Administrimi, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit pjesë në të gjithë territorin;
b. Rritja e kapaciteteve ujëmbledhëse në territorin e bashkisë ;
c. Mbrojtja e tokës bujqësore;
d. Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor e rural në shërbim të fermerëve;
e. Administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë , zhvillimin rural;
f. Administrim sa më i mirë dhe transparent i fondit pyjor e kullusor ;

Në fushën e zhvillimit ekonomik vendor:

a. Hartimin e planeve strategjike të zhvillimit të programeve për një zhvillim ekonomik vendor të qëndrueshëm;
b. Ngritjen dhe funksionimin e tregjeve publike dhe të rrjetit të tregëtisë
c. Mbështetje për zhvillimin e biznesit të vogël, nëpërmjet veprimtarive nxitëse si panaire e reklama në vende publike;
d. Organizimin e shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik e vënien e aseteve publike në dispozicion të bizneseve bazuar në aktet ligjore në fuqi;
e. Krijimin e profilit ekonomik e informacioneve informuese ;

Siguria Publike

a. Mbrojtjen civile në nivel vendor dhe administrim sa më të mirë të strukturave vendore ;
b. Garantimin e shërbimit zjarrfikës dhe ngritjen profesionale të tyre;
c. Parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve në komunitet;
d. Parandalimin e kundravajtjeve administrative ;

Funksionet dhe Kompetencat e Deleguara

- Janë funksione dhe kompetenca që institucionet qëndrore kalojnë në funksion të pushtetit lokal me akte ligjore në fuqi duke i mbështetur edhe financiarisht për ushtrimin e një funksioni apo kompetence të deleguar.
- Bashkia mund të financojë edhe nga fondet e veta në përmirësimin e një shërbimi ndaj komunitetit edhe pse është funksion i deleguar;

Në Fushën e Taksave dhe Tatimeve vizioni jonë do jetë:

1. Forcimi i disiplinës fiskale në zbatimin e drejtë, të ndershëm dhe eficient të procedurave tatimore, si mjet kryesor për reduktimin e evazionit fiskal dhe krijimin e një sistemi të drejtë tatimor.

2. Krijimi i sistemeve dhe rrjeteve të informacionit dhe ofrimi i shërbimeve ndaj taksapaguesve nëpërmjet teknologjisë së informacionit, si dhe të shërbimit në një sportel. Informatizimi dhe lidhja në një rrjeti të vetëm i të gjithë informacionit brenda territorit (Struktura të Bashkisë, Njësitë Administrative. Bankat e nivelit të dytë etj.)

3. Vendosja dhe zbatimi i rregullave transparente në rekrutimin, karrierën dhe zbatimin e masave disiplinore për punonjësit në përputhje me rregullat bazë të Shërbimit Civil.

4. Edukimi fiskal i publikut dhe forcimi i marrëdhënieve me publikun taksapagues për rritjen e besueshmërisë ndaj administratës fiskale dhe zbatimin vullnetar të legjislacionit tatimor. Për këtë do të iniciohen programe edukative si dhe do të prodhohen guida dhe materiale të tjera informative. Qytetarët dhe bizneset do të informohen për të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore.

<u>Në fushën e Financave Vendore</u>

1. Burimet financiare si dhe ndikimi fiskal në kushtet për zbatimin e strategjisë – do të jenë kërkesat për burimet financiare për zbatimin e strategjisë.

2. Kërkesat për burime financiare për vitet 2025-2029 do të jenë baza për faktorët e zhvillimit për mbështetjen e zbatimit të strategjisë. - Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, nëpërmjet të cilave burimet financiare janë planifikuar, drejtuar dhe kontrolluar për të mundësuar dhe influencuar ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike.

3. Forcimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë të saj fiskale. Shfrytezimi i legjislacionit të decentralizimit fiskal që do të vazhdojë edhe më tej, do të krijojë mundësi që veteqeverisja vendore të këtë më shumë burime financiare, në mënyrë që të kryejë funksionet dhe kompetencat e saj në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

4. Përdorimit me efikasitet i transfertës të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke siguruar transparencë dhe efikasitet si dhe bashkërendim me objektivat strategjike.

5. Ndërtimi i një modeli të ri të harmonizuar të zhvillimit social-ekonomik dhe territorial, duke synuar uljen e pabarazisë që egziston në zhvillim midis zonave dhe territoreve të Bashkise.

6. Mbështetje të Planeve Strategjike të Zhvillimit të zonës, që do hartohet nga njësia jonë vendore në përputhje edhe me politikat rajonale të zhvillimit.

7. Qeverisjen më të mirë në nivel vendor të Bashkisë sonë, përparësi do të ketë forcimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit, të biznesit dhe të shoqërisë civile në vendimmarrjen publike në nivel vendor

Në përfundim :

"Të bashkohemi të gjithë e të punojmë si një familje e madhe e vetme, në interes të secilit dhe në interesin e të gjithëve, për një Bashki me emër të mirë ashtu siç e meritojmë".

Bashkia Maliq tashmë është një institucion ambicioz, i një qeverisje vendore vullnetmirë dhe bashkëpunuese që bën përpjekjet dhe jep shembullin e maksimalizimit për përfitueshmëri dhe zgjidhje të sfidave e projekteve të zhvillimit për bashkinë dhe komunitetin.

- ***Synimi jonë është të shuhen diferencat në zhvillim, shërbime dhe infrastrukturë*** midis zonave më të largëta deri në qendër të saj.
- ***Të përfshijmë të rinjtë e sotëm dhe të përgatisim rininë e së ardhmes,*** për të drejtuar dhe zhvilluar bashkinë e re si njësi bazë të integrimit në Europë.
- ***Të shkurtojmë distancat dhe rrisim aksesin në Punë, Arsim dhe Shërbim*** të familjeve në çdo njësi adminstrative.

Të shndërrojmë bashkinë në qendër të zgjidhjes së problemeve sociale dhe të ndihmës për çdo qytetar.

Është shumë e rëndësishme të pohojmë se duhet të qeverisim bazuar në strategjinë dhe dokumentat bazë që udhëheqin zhvillimin për një të ardhme të qëndrueshme të bashkisë.

Si bashki kemi hartuar **Strategjinë e Zhvillimit të Ekonomisë Vendore** (Plani Strategjik i Zhvillimit Ekonomik) ,si dhe strategjitë sektoriale për çdo fushë të veprimtarisë së qeverisjes vendore.

Kemi tashmë të miratuar një **Plan të Përgjithshëm Vendor,** si bazë e zhvillimit tonë, "Kushtetutë e Zhvillimit Urban të Bashkisë" i cili po implementohet, duke i dhënë fund kaosit urban në këto dhe zhvillimit të territorit sipas vizionit dhe qëllimeve të këtij plani.

Faleminderit !

KRYETARI I BASHKISË

GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ